



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE**  
**DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

Nr. 9384 prot.

Tiranë, më 23.11.2017

**MIRATOHET**  
**ASTRIT HADO**  
**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**



**RREGULLORE**  
**PËR**  
**FUNKSIONIMIN E FAQES SË INTERNETIT**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Objekti**

Kjo Rregullore përcakton procedurat në lidhje me funksionimin e faqes zyrtare të internetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Komunikimi me Median dhe Publikun, botimet dhe Website i Institutit të Sigurimeve Shoqërore përmbushin detyrimin për transparencë maksimale në veprimtarinë e Institucionit dhe janë në funksion të rritjes së besueshmërisë së publikut ndaj nesh. Komunikimi në kuptimin e kësaj Rregulloreje përfshin të gjitha mënyrat e shkëmbimit të informacionit në formë teksti, figurash, videosh apo të dhënash.

## Neni 2

### Qëllimi

Faqja zyrtare e internetit duhet të shihet si një burim informacioni që mbart standartet dhe praktikën më të mirë të udhëzimeve për institucionin.

Faqja e internetit duhet të ketë përmbajtje informuese dhe të përditësuar, që iu përgjigjet kërkesave të një game të gjerë audience dhe që është e lehtë për t'u aksesuar.

Informacioni i paraqitur në faqen e internetit duhet të jete i saktë, për të shmangur dëmtimin dypalësh të Qeverisë ose të qytetarit, si pasojë e publikimit të një informacioni jokorrekt.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, nëpërmjet faqes zyrtare të internetit ka përgjegjësi për t'iu ofruar informacione dhe shërbime të gjitha shtresave të komunitetit, si dhe të minimizojë efektet e “ndarjes dixhitale”, duke u siguruar që të gjithë qytetarët të kenë akses të njëjtë në shërbimet dhe informacionet online.

Në mënyrë të veçantë kjo faqe duhet që:

- Të ofrojë informacion të mjaftueshëm, aktual dhe të saktë, në një stil të përshtatshëm për faqen e internetit;
- Të jetë e mirë-dizenjuar;
- Të sigurojë aksesim për numrin më të madh të mundshëm të përdoruesve të shtresave të ndryshme të komunitetit;
- Mbrojtja e privatësisë së përdoruesit në faqen e internetit duhet të jete e siguruar;
- Të zbatojë të gjitha kërkesat ligjore të institucionit;
- Të jetë e pasur në përmbajtje.

## Neni 3

### Përmbajtja

Faqja Zyrtare, me të cilën ISSH përfaqësohet në Internet, duhet të ofrojë transparencë për veprimtarinë e institucionit. Informacioni duhet të publikohet në kohë reale.

Çdo informacion në faqen zyrtare të internetit publikohet në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.

Në faqen zyrtare të ISSH-së duhet të përdoret gjuhë letrare dhe një drejtshkrim i saktë.

Faqja e parë kryesore (homepage) domosdoshmërisht duhet të përmbajë:

1. Simbolet kombëtare;
2. Emërtimin e institucionit;
3. Stemën e institucionit;
4. Një link për Kontakte që të ketë emrin, adresën, telefon dhe faks;
5. Rubrikën Pyesni online, në të cilën duhet të vendoset deklarata e privatësisë;
6. Rubrikën Denonco online, në të cilën duhet të vendoset deklarata e privatësisë;
7. Strukturën organizative të institucionit;
8. Informacion ndihmës për klientët;
9. Informacion ligjor;
10. Raporte mbi gjendjen financiare;
11. Një link për informacionet më të fundit;
12. Për më shumë transparencë dhe edukimin e publikut, faqes së internetit duhet t'i bashkëngjitet edhe një Fjalor me sqarimin e terminologjisë kryesore mbi sigurimet shoqërore;
13. Adresat e e-mail të sistemit të sigurimeve shoqërore;
14. Linkun e institucioneve me të cilat bashkëpunon ISSH.

#### Neni 4

##### Mirëmbajtja e Faqes Zyrtare të Autoritetit

1. Emri (Domain) i faqes zyrtare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore është [www.iss.gov.al](http://www.iss.gov.al);
2. Shërbimi i mirëmbajtjes së faqes zyrtare, i cili përmban hostimin e faqes si dhe modifikimin e informacionit në nivel databaze, përfshirë këtu edhe sistemin GSRM kryhet nëpërmjet Outsourcing, ku në kontratë përcaktohen qartë siguria e faqes, si dhe shërbimi i hostimit në një server të dedikuar për këtë qëllim;

3. Faqja zyrtare mbikëqyret dhe auditohet gjatë gjithë kohës. Në raste të sulmeve kibernetike faqja kthehet brenda 24 orëve në shërbimin online me informacionin më të fundit të saj;
4. Aksesin në informacione të veçanta, e kanë vetëm përdoruesit e autorizuar;
5. Atributin për fshirje dhe modifikim informacioni e ka vetëm Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, e cila garanton qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave;
6. Menaxhimi dhe përditësimi i saj ndiqet nga specialisti i Informimit Publik, pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun;
7. Çdo informacion në faqe publikohet në formatin “PDF”, për të mos lejuar modifikimin e tij;
8. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit mban përgjegjësi për mbarëvajtjen nga ana teknike të faqes.

## **Neni 5**

### **Hyrja në Fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.